


RAPORT ANALITIK

ZBATIMI I BUXHETIMIT TË PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI

DREJT REFORMAVE
TË QËNDRUESHME



Funded by
the European Union



Budget
Accountability
and Transparency

Autorja: Prof. Nadia Rusi

2025

Botues: Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Rr. Shenasi Dishnica,
Nd. 35, H. 1, 1017, Tirana, Albania P.O.Box 8177. Email: info@idmalbania.org
| Website: idmalbania.org

Riprodhimi i pjesëve të këtij botimi lejohet vetëm duke cituar burimin original.

Ky dokument është prodhuar në kuadër të nismës “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në të i përka-
sin vetëm autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Institute
for Democracy
and Mediation



Center for
Research and
Policy
Making

... policy impact since 2004



Fakt@je.al

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	04
I. Hyrje	06
II. Pse është e nevojshme analiza gjinore në politikëbërje dhe buxhetim?	08
III. Kudri ligjor dhe strategjik për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në Shqipëri	11
IV. Arkitektura institucionale dhe mekanizmat e zbatimit të BPGJ	13
V. Zbatimi i BPGJ në nivel vendor dhe qendror dhe sfidat kryesore	15
VI. Gjetje Kryesore dhe sfidat e aplikimit të BPGJ në politikat publike	17
VII. Praktika Pozitive të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Shqipëri	20
VIII. Rekomandime Strategjike për forcimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor	22

Përmbledhje Ekzekutive

Ky dokument politikash analizon në mënyrë gjithëpërfshirëse zbatimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinator (BPGJ) në Shqipëri, duke u fokusuar si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor. Ai ofron një përmbledhje të kuadrit ligjor dhe strategjik ekzistues, institucioneve përgjegjëse, praktikave të zbatuara, si dhe rekomandimeve për të përforcuar këtë praktikë në menaxhimin e financave publike. Dokumenti mbështetet në të dhëna sasiore dhe cilësore të mbledhura nëpërmjet analizës së programeve buxhetore dhe monitorimit të shpenzimeve publike, në nivel qendror dhe vendor.

BPGJ ka hyrë në agjendën e reformave të financave publike në Shqipëri prej më shumë se një dekade, duke reflektuar angazhimin e qeverisë për të ndërtuar një sistem buxhetor gjithëpërfshirës dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme gjinore. Në aspektin normativ dhe institucional, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm me përfshirjen e barazisë gjinore si një nga parimet themelore në Ligjin Organik të Buxhetit (2016) dhe Ligjin për Financat Vendore (2017), si dhe me përfshirjen e objektivave të lidhura me barazinë gjinore në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030, Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030. Ministria e Financave ka udhëhequr procesin e institucionalizimit të BPGJ në ciklin e buxhetimit, ndërkohë që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka kontribuar në ndërgjegjësimin dhe mbështetjen për integrimin gjinor në hartimin e politikave.

Nga pikëpamja e progresit sasior, Shqipëria ka shënuar një rritje të ndjeshme të programeve buxhetore që integrojnë perspektivën gjinore – nga vetëm 1% e buxhetit të shtetit në vitin 2015, në rreth 9.1% të shpenzimeve buxhetore për vitin 2025. Po ashtu, numri i programeve buxhetore që përfshijnë analiza dhe objektiva gjinore është rritur nga 19 në vitin 2016 në 77 në vitin 2025, përfshirë 11 ministri të linjës dhe 26 institucione të tjera qendrore. Këto programe janë përqendruar kryesisht në sektorët e mbrojtjes sociale, arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, rendit publik, dhe bujqësisë.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, dokumenti identifikon një sërë sfidash strukturore që rrezikojnë të frenojnë efektivitetin dhe ndikimin real të BPGJ. Ndër to përfshihen:

- Pesha ende e ulët e fondeve me ndjeshmëri gjinore në raport me totalin e buxhetit shtetëror;
- Mungesa e një lidhjeje të drejtpërdrejtë midis rritjes së numrit të programeve gjinore dhe rritjes së fondeve të dedikuara;
- Mungesa e kapaciteteve teknike për analizën gjinore dhe hartimin e objektivave të matshme;
- Zbatimi i paplotë i objektivave gjinore të përfshira në buxhet;
- Mungesa e të dhënave të detajuara dhe të disagreguara sipas gjinisë që të mundësojnë planifikimin dhe monitorimin e bazuar në evidencë.

Në nivel vendor, sfidat janë edhe më të theksuara. Zbatimi i BPGJ në shumicën e bashkive është sporadik dhe i fragmentuar, i kufizuar në raste të veçuara ku janë përfshirë produkte buxhetore me ndjeshmëri gjinore, kryesisht në bashkitë që kanë hartuar Plane Vendore për Barazi Gjinore. Megjithatë, edhe në këto raste, pesha buxhetore e këtyre produkteve është e vogël dhe shpesh mbështetet nga transfertat e kushtëzuara nga qeveria qendrore. Bashkitë përballen me burime të kufizuara financiare, mungesë stafi të specializuar, dhe mungesë të theksuar të të dhënave gjinore në nivel lokal.

Duke pasur parasysh këto gjetje, dokumenti politik propozon një sërë rekomandimesh strategjike të ndara sipas fushave prioritare të ndërhyrjes. Këto rekomandime përfshijnë forcimin e kuadrit ligjor për BPGJ, zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore në të gjitha nivelet e administratës publike, integrimin sistematik të analizës gjinore në planifikimin buxhetor, përmirësimin e të dhënave gjinore, si dhe ndërtimin e mekanizmave të qëndrueshëm të monitorimit dhe llogaridhënies. Rekomandimet synojnë të sigurojnë që BPGJ të mos mbetet një proces formal apo teknik, por të shndërrohet në një instrument të fuqishëm për transformimin social dhe ekonomik të vendit.

I. Hyrje

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjnor (BPGJ) është një instrument për të siguruar që angazhimet politike për arritjen dhe respektimin e barazisë gjnore në nivel të pushtetit qendror dhe nivel të qeverisjes vendore (NJVV), të reflektohen dhe realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit. Në terma më specifikë, BPGJ është një mjet i njohur botërisht që siguron arritjen e barazisë gjnore nëpërmjet:

- përfshirjes së një perspektive gjnore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë gjnore;
- bashkërendimit të përpjekjeve për barazi gjnore dhe menaxhimit të financave publike;
- analizimit të ndikimeve të ndryshme që politikat fiskale dhe buxhetore kanë mbi gratë dhe burrat;
- kontributit që ofron në alokimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore. (MF, 2018)¹

Sa më sipër, BPGJ është analizuar për qëllime të këtij dokumenti politikash si mjet për të integruar perspektivën gjnore në të gjithë hapat e procesit buxhetor – planifikim, hartim, zbatim dhe vlerësim – për të siguruar që politikat buxhetore në nivel qendror dhe vendor marrin në konsideratë çështjet gjnore në shoqëri (UN Women, 2019).²

Në terma të përgjithshëm, shumica e qeverive shprehin një përkushtim ndaj arritjes së qëllimeve të barazisë gjnore, por shpesh ka mospërputhje midis deklaratave të politikave dhe mënyrave në të cilat financat publike mbledhen dhe shpenzohen (Birchall.J dhe Fontana.M, 2015).³ Buxhetimi i përgjigjshëm gjnor sugjeron se nëse nuk analizohet në mënyrë të thelluar impakti i shpenzimeve publike mbi burrat dhe gratë, ekziston rreziku që pabarazitë e lidhura me gjininë dhe hendeku gjnor në fushën ekonomike, sociale, politike apo kulturore të vijë duke u thelluar (Bryn Welham, Karen Barnes-Robinson et al, 2018).⁴ Monitorimi i shpenzimeve publike sipas gjinisë në secilën prej këtyre fushave është me rëndësi në kuadër të analizës së ndjeshmërisë dhe përgjegjshmërisë së qeverisë në nivel qendror dhe vendor ndaj politikave mbi barazinë gjnore dhe realizimit të nevojave dhe prioriteteve të veçanta të burrave dhe grave.

Në Shqipëri, integrimi i perspektivës gjnore në procesin e planifikimit dhe menaxhimit të financave publike përfaqëson një detyrim ligjor dhe strategjik, i mbështetur në angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazi gjnore. Shteti shqiptar ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme për të ndërtuar një kuadër të qëndrueshëm ligjor dhe institucional në funksion të fuqizimit të grave dhe përparimit të barazisë gjnore në përgjithësi. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë

dhe Mbrojtjes Sociale ka qenë i rëndësishëm në nxitjen e ndërhyrjeve fillestare dhe në advokimin për integrimin e çështjeve gjinore në të gjitha nivelet e hartimit të politikave dhe planifikimit buxhetor. Ndërkohë, Ministria e Financave ka udhëhequr reformat më të rëndësishme në fushën e modernizimit të financave publike, duke përfshirë Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor si pjesë përbërëse të tyre.

Në kontekstin ligjor, barazia gjinore është përfshirë si një nga parimet themelore të buxhetimit në Ligjin Organik të Buxhetit⁵ (2016) dhe në Ligjin për Financat e Vetëqeverisjes Vendore (2017)⁶, ndërsa BPGJ është inkorporuar si objektivi i drejtpërdrejtë në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike që prej vitit 2014 dhe Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030⁷. Përmë tepër, përmes udhëzimeve të Ministrisë së Financave për hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, janë përforcuar kërkesat për adresimin e barazisë gjinore në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të financave publike: planifikim, zbatim, monitorim dhe auditim (MF, 2018, 2021).⁸ Në këtë kuadër, institucionet qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë detyrime të qarta për të përfshirë objektiva që adresojnë pabarazitë gjinore në programet e tyre buxhetore, të shoqëruara me produkte të identifikuar dhe tregues të matshëm gjinorë duke e shndërruar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor nga vetëm një mjet teknik për integrimin e barazisë gjinore në hartimin dhe ekzekutimin e buxheteve, në një strategji gjithëpërfshirëse për të adresuar pabarazitë

gjinore në të gjitha fushat ekonomike, sociale, kulturore dhe politike.

Ky dokument politikash është hartuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim me synimin për të ofruar një analizë mbi progresin dhe sfidat që lidhen me zbatimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Shqipëri. Ai synon të identifikojë boshllëqet strukturore dhe institucionale, të dokumentojë praktikën e mira të zhvilluara në nivel qendror dhe vendor, si dhe të propozojë orientime të qarta për forcimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të BPGJ si një mekanizëm funksional për avancimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe të menaxhimit të financave publike. Në këtë kuadër, dokumenti kontribuon në rritjen e ndjeshmërisë dhe të vëmendjes së shoqërisë civile ndaj shpërndarjes së shpenzimeve publike sipas nevojave të grupeve vulnerabël, ndërsa njëkohësisht i jep mundësi IDM të formulojë rekomandime konkrete për institucionet në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore mbi mënyrën e hartimit të buxheteve të përgjigjshme gjinore dhe shpërndarjes së drejtë të fondeve publike.

II. Pse është e nevojshme analiza gjinore në politikëbërje dhe buxhetim?

Në kuadrin e përpjekjeve për zhvillim të qëndrueshëm dhe barazi sociale, analiza gjinore paraqitet si një mjet thelbësor për hartimin e politikave publike më të drejta dhe më efektive. Përfshirja e saj në procesin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe të vendimmarrjes ndihmon në kuptimin më të mirë të ndikimeve të ndryshme që politikat kanë mbi gratë dhe burrat, si dhe në sigurimin që askush të mos mbetet pas. Në Shqipëri, ku pabarazitë gjinore dhe përjashtimi social janë ende të pranishme, kryerja e analizave gjinore nuk është vetëm një domosdoshmëri për zbatimin e angazhimeve ligjore dhe ndërkombëtare, por një kusht i padiskutueshëm për një zhvillim të drejtë dhe gjithëpërfshirës.

Nevoja për analizën gjinore të shpenzimeve publike e ka bazën tek pranimi i faktit se gratë dhe burrat priren të kenë role dhe përgjegjësi të ndryshme ekonomike, si dhe qasje të ndryshme në burimet prodhuese dhe në shumicën e rasteve, gratë priren të jenë në disavantazh (Birchall.J dhe Fontana.M, 2018).⁹ Për shembull, gratë zakonisht pritet që të marrin përsipër pjesën më të madhe të kujdesit për familjet e tyre. Kjo do të thotë se gratë (shumë më shumë se burrat) kanë

barrën e dyfishtë të kryerjes së punës së paguar dhe të papaguar. Ky rol i dyfishtë shpesh ka efektin e minimizimit të pozitës së grave në tregun e punës me pagesë, ku ato mund të kenë akses vetëm në një gamë të kufizuar sektorësh dhe profesionesh, dhe mund të kufizojnë mundësitë e tyre për të hyrë në tregje dhe shërbime të tjera gjithashtu.

Konkretisht, bazuar në të dhënat e 2024, 16.9 % e grave në Shqipëri kanë mbetur jashtë forcës së punës duke përmbushur detyrat shtëpiake, krahasuar me vetëm 0,8 % e burrave që kanë si arsye të inaktivitetit të tyre përmbushjen e detyrave shtëpiake (INSTAT, 2024).¹⁰ Ndërkohë, struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4 % e grave janë të punësuar me pagë, ndërsa 23,5 % e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht 42,8 % dhe 13,8 % (INSTAT, 2024).¹¹ Nga ana tjetër, duhet të pranojmë se barra e dyfishtë dhe pozita e pabarabartë e grave dhe burrave në familje, ka të ngjarë t'i bëjë gratë më të cënueshme brenda familjes së tyre. Vetëm nga të dhënat e vitit 2024, rezulton se gratë përbëjnë 67.8 % të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare krahasuar me 26.8% të burrave (INSTAT, 2024).¹²

Po kështu, referuar të dhënave në lidhje me tregun e punës, të dhënat statistikore tregojnë për një diferencë në normën e papunësisë në vitin 2024 me 11.7% për gratë dhe 10.9% për burrat (INSTAT,2024).¹³ Hendeku gjinor në paga ishte 6.2% në favor të burrave, duke arritur kulmin në sektorin e prodhimit me 21.3% (INSTAT,2024).¹⁴ Gratë përbënin 64.8% të kontribueseve vullnetare në sigurimet shoqërore dhe 54.9% të përfituesve të ndihmës së papunësisë. Këto të dhëna ilustrojnë njëkohësisht cenueshmërinë dhe pabarazinë gjinore në sistemin ekonomik të Shqipërisë, duke nënvizuar domosdoshmërinë për integrimin e masave të ndjeshme gjinore në politikat buxhetore dhe të tregut të punës. Ndërkohë, në një këndvështrim më të thelluar, analiza gjinore e politikave nuk duhet kufizuar vetëm në dimensionin buxhetor, pasi edhe orientimi i investimeve drejt teknologjive të reja mund të sjellë pasoja të padëshiruara për gratë, veçanërisht në tregun e punës. Një shembull i qartë është qeverisja elektronike dhe kalimi gradual i shërbimeve publike në platforma online, proces që ka ndikuar në reduktimin e punësimit të grave në disa sektorë të administratës publike. Për këtë arsye, bëhet e domosdoshme kryerja e analizave ex ante për politikat dhe reformat e planifikuara, me synim vlerësimin paraprak të impaktit gjinor dhe përcaktimin e masave kundërbalancuese në rast të efekteve negative.

Në lidhje me këtë, shembuj ndërkombëtarë ilustrojnë se pabarazitë gjinore në qasjen dhe përdorimin e teknologjive nuk janë fenomen vetëm shqiptar, por një sfidë globale. Raporti i UNICEF (2022) tregon se ekziston një hendek i theksuar gjinor në përdorimin e shërbimeve

digjitale, ku burrat kanë më shumë gjasa të përdorin internetin dhe një gamë më të gjerë platformash krahasuar me gratë.¹⁵ Kjo do të thotë se gratë, në mungesë të një adoptimi dhe përdorimi më të gjerë të teknologjive, përballen me më pak mundësi punësimi dhe barriera shtesë për integrimin në tregun e punës. Për më tepër, studimi ka identifikuar një “disavantazh të trefishtë” për gratë: një hendek rural-urban në përdorimin e internetit, një hendek të ardhurash ku familjet me të ardhura të ulëta kanë akses më të kufizuar si dhe diskriminim brenda familjes ku normat shoqërore shpesh i kufizojnë gratë në përdorimin e mjeteve digjitale. Këto dinamika tregojnë se një grua nga një familje rurale me të ardhura të ulëta ka shumë më pak mundësi të aftësohet me mjete digjitale, të përdorë burime online ose të bëhet pjesë aktive e tregut të punës digjital. Ky ilustrim ndërkombëtar tregon qartë se, nëse nuk merren masa të synuara, tranzicioni digjital mund të thellojë pabarazitë gjinore ekzistuese edhe në Shqipëri. Kjo nënvizon më tej nevojën për integrimin sistematik të perspektivës gjinore në hartimin e reformave publike dhe në procesin e tranzicionit digjital, duke siguruar që zhvillimet teknologjike dhe politikat përkatëse të mos krijojnë barriera shtesë për gratë, sidomos për ato në zonat rurale, të cilat përballen me sfida më të mëdha për sa i përket qasjes në infrastrukturë dhe aftësi digjitale. Bazuar në sa më lart, monitorimi dhe analiza e mënyrës se si qeveritë në nivel qendror apo vendor mbledhin, shpërndajnë dhe shpenzojnë paratë ka potencialin për të reduktuar ose përforcuar pabarazitë me bazë gjinore (Bichall.J dhe Fontana.M, 2015).¹⁶

Po kështu, analiza gjinore në politikëbërje dhe buxhetim nuk duhet të shihet si një artificë teknike, por si një mekanizëm thelbësor për të garantuar që zhvillimi ekonomik dhe social të mos riprodhojë pabarazitë ekzistuese. Integrimi i saj sistematik krijon mundësinë që politikat dhe reformat – qofshin ato buxhetore, sociale apo teknologjike – të projektohen mbi parimin e barazisë dhe të drejtësisë, duke u përgjigjur në mënyrë të drejtë dhe proporcionale ndaj nevojave të grave dhe burrave. Vetëm përmes kësaj qasjeje mund të ndërtohen politika publike që jo vetëm përbushin detyrimet ligjore dhe ndërkombëtare të Shqipërisë, por edhe garantojnë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

III. Kuadri ligjor dhe strategjik për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në Shqipëri

Siç e cituam edhe më sipër, kuadri ligjor dhe strategjik për BPGJ në Shqipëri është relativisht i zhvilluar dhe përfshin një sërë dispozitash ligjore e aktesh nënligjore në nivel qendror dhe vendor. Në nivel qendror, Ligji nr. 9936/2008 ‘Për menaxhimin e sistemit buxhetor’, i ndryshuar me ligjin nr. 57/2016, përcakton barazinë gjinore si një nga parimet bazë të sistemit buxhetor. Udhëzimi nr. 7/2018 i Ministrisë së Financave detyron institucionet në nivel qendror të përfshijë brenda çdo programi buxhetor objektiva që promovojnë barazinë gjinore dhe të identifikojë tregues të matshëm gjinorë. Në nivel vendor, Ligji nr. 68/2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’ dhe udhëzimi nr. 23/2018 detyrojnë bashkitë të përfshijnë të paktën një objektiv me bazë gjinore në çdo program buxhetor.

Megjithatë, në terma të kësaj analize vlen të theksojmë se edhe pse udhëzimet për hartimin e buxhetit afatmesëm dhe vjetor përfshijnë një aneks për buxhetimin gjinor, ky instrument është ende i pamjaftueshëm për të ofruar një udhëheqje metodologjike të plotë për institucionet. Shembulli i Komisionit European, i cili ka zhvilluar një metodologji specifike të zbatueshme nga shtetet anëtare,

është ilustrues për mënyrën se si ky boshllëk mund të mbushet edhe në Shqipëri (KE, 2023).¹⁷ Në këtë kuadër, rekomandohet themelimi i një procedure të plotë për vlerësimin dhe rivlerësimin e buxheteve gjinore, duke përfshirë si projektet me ndikim të drejtpërdrejtë ashtu edhe ato me ndikim të tërthortë.

Në nivel strategjik, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor ka qënë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015- 2020 dhe 2022-2030, duke u vendosur në këtë mënyrë në strategjinë ombrellë të të gjithë kuadrit strategjik në Shqipëri. Në harmonizim me SKZHI, koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është përkthyer në objektiva specifike dhe masa si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Konkretisht, Qëllimi strategjik IV i kësaj strategjie “Aplikimi i integritetit gjinor si mjet për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri” parashikon dy objektiva specifike që i referohen konkretisht monitorimit dhe mbështetjes për BPGJ në të dyja nivelet e qeverisjes.¹⁸

Brenda kontekstit ligjor, një zhvillim i rëndësishëm është gjithashtu nisma e ndërmarrë në vitin 2024 për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në draftligjin e ri për Barazinë Gjinore në Shoqëri. Përfshirja eksplicite e BPGJ në një ligj tematik për barazinë gjinore pritet të përforcojë më tej detyrimet ligjore për të gjitha institucionet publike, të nxisë përgjegjshmëri më të lartë dhe të mundësojë ndërlidhjen midis politikave të barazisë dhe menaxhimit të financave publike në një mënyrë të integruar.

Në nivel vendor, një zhvillim i rëndësishëm lidhet me nismat e disa bashkive për të përfshirë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në planet vendore për barazinë gjinore. Këto përpjekje të pushtetit vendor tregojnë potencialin për institucionalizimin e BPGJ në nivel vendor, por njëkohësisht nënvizojnë nevojën që miratimi i planeve të tilla të bëhet praktikë e detyrueshme për të gjitha bashkitë e vendit. Kjo do të garantonte që objektivat ligjore të përkthyer në Ligjin nr. 68/2017 dhe udhëzimin nr. 23/2018 të zbatohen realisht dhe të mos mbeten në nivel formal.

Ky kuadër ligjor dhe strategjik tregon se Shqipëria ka tashmë një bazë të rëndësishme ligjore dhe strategjike për BPGJ, por konsolidimi i tij kërkon standardizimin e praktikave vendore, forcimin e udhëzuesve metodologjikë dhe përafrimin me praktikat më të mira të BE-së dhe OECD-së. Vetëm përmes kësaj qasjeje, buxhetimi gjinor do të kthehet në një mekanizëm funksional, që ndikon realisht në shpërndarjen e barabartë të burimeve dhe avancimin e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e qeverisjes.

Në të njëjtën kohë, avancimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Shqipëri kërkon një qasje të qëndrueshme institucionale, investim në kapacitete njerëzore, përmirësim të sistemit të të dhënave, dhe angazhim të vazhdueshëm politik për të shndërruar angazhimet strategjike në rezultate konkrete për qytetarët, veçanërisht për ata që kanë qenë tradicionalisht të nënpërfaqësuar ose të përjashtuar.

IV. Arkitektura institucionale dhe mekanizmat e zbatimit të BPGJ

Zbatimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjnor në Shqipëri mbështetet në një arkitekturë institucionale të ndërlikuar që përfshin aktorë të shumtë në nivelet qendror dhe vendor. Në thelb të këtij sistemi qëndron Ministria e Financave (MF), e cila ka një rol kyç udhëheqës në hartimin e udhëzimeve teknike për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) dhe në monitorimin e përfshirjes së elementëve gjnorë në ciklin e planifikimit buxhetor. Udhëzimet e saj kërkojnë që çdo institucion të përfshijë të paktën një objektiv të ndjeshëm gjnor dhe të identifikojë tregues për matjen e progresit drejt barazisë gjnore në programet përkatëse.

Përveç rolit teknik, MF ka qenë një promotor i rëndësishëm i procesit të institucionalizimit të BPGJ përmes përfshirjes së tij në reformën e menaxhimit të financave publike, zhvillimit të instrumenteve praktike dhe trajnimit të administratës publike. Megjithatë, përkundër këtij angazhimi, kapacitetet teknike të brendshme për të realizuar një analizë cilësore gjnore dhe për të vlerësuar ndikimin gjnor të buxheteve janë ende të kufizuara dhe të përqendruara në një grup të vogël specialistësh.

Në këtë kuadër, përgjegjësitë për integrimin e BPGJ nuk qëndrojnë vetëm në MF. Ministritë e linjës dhe institucionet qendrore kanë detyrimin të përfshijnë objektiva gjnorë në programet e tyre, duke reflektuar nevojat specifike të grave dhe burrave në fushat përkatëse të politikave publike. Megjithatë, kjo përfshirje shpesh mbetet formale, pa mbështetje të mjaftueshme nga analiza paraprake gjnore, dhe në shumë raste varet nga vullneti i individëve të caktuar brenda institucioneve. Kjo tregon mungesën e një mekanizmi të qëndrueshëm institucional për zbatimin e BPGJ në nivel sektorial.

Në nivelin e qeverisjes vendore, përgjegjësia për integrimin e BPGJ bie mbi bashkitë, të cilat përmes grupeve të menaxhimit strategjik duhet të identifikojnë objektiva dhe tregues gjnorë në programet buxhetore. Legjislacioni në fuqi parashikon që çdo bashki të përfshijë të paktën një objektiv të ndjeshëm gjnor në programimin buxhetor vjetor dhe afatmesëm. Por në praktikë, mungesa e kapaciteteve teknike, burimeve njerëzore të specializuara dhe të dhënave të detajuara e bën këtë kërkesë të vështirë për t'u përmbushur në mënyrë cilësore. Në shumë raste, përfshirja gjnore në buxhetet vendore është rezultat i projekteve të mbështetura nga partnerë zhvillimi dhe nuk është ende një praktikë e institucionalizuar.

Një rol të rëndësishëm në këtë arkitekturë kanë edhe nëpunësit përgjegjës për çështjet gjinore, të cilët ekzistojnë në shumicën e institucioneve publike si në nivelin qendror, ashtu edhe në atë vendor. Megjithatë, mandati i tyre për të ndikuar në proceset e buxhetimit është i kufizuar. Ata shpesh ngarkohen me detyra të ndryshme administrative, pa një pozicion të dedikuar dhe pa mbështetje të nevojshme për të ushtruar ndikim real në hartimin dhe monitorimin e buxheteve nga perspektiva gjinore.

Institucionet e pavarura si Avokati i Popullit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit kanë gjithashtu një rol për të luajtur në sigurimin e llogaridhënies dhe respektimit të parimit të barazisë gjinore në menaxhimin e financave publike. Përpjekje të fundit nga KLSH për të përfshirë elementë të analizës gjinore në auditimet e tij përfaqësojnë një hap pozitiv, por mungon një qasje e institucionalizuar dhe sistematike në këtë drejtim. Po kështu, shoqëria civile ka kontribuar në promovimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor përmes avokimit dhe monitorimit, megjithëse përfshirja e saj në ciklin buxhetor mbetet sporadike dhe jo e strukturuar në mënyrë të qëndrueshme, veçanërisht në nivel vendor.

Një sfidë e përbashkët për të gjithë këtë arkitekturë institucionale mbetet mungesa e koordinimit efektiv ndërinstitutional. Ndarja e përgjegjësiave shpesh mbetet formale dhe mungojnë mekanizmat e përhershëm për bashkëpunim horizontal midis ministrive, si dhe vertikal midis qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Kjo mungesë koordinimi e kombinuar me kapacitete teknike të pamjaftueshme për kryerjen e analizave paraprake gjinore, mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë kufizon në mënyrë të ndjeshme potencialin e BPGJ për të transformuar politikat publike në funksion të barazisë gjinore dhe drejtësisë sociale. Për rrjedhojë, avancimi i mëtejshëm i BPGJ në Shqipëri kërkon fuqizim real të kapaciteteve institucionale dhe rritje të llogaridhënies ndërinstitutionale. Vetëm në këtë mënyrë, BPGJ mund të përmbushë funksionin e tij si një instrument transformues për politika publike më të ndershme, efektive dhe gjithëpërfshirëse.

V. Zbatimi i BPGJ në nivel vendor dhe qendror dhe sfidat kryesore

Nga viti 2015 deri në vitin 2025, Shqipëria ka shënuar progres të ndjeshëm në zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ). Sipas të dhënave nga Ministria e Financave, në vitin 2015 vetëm 1% e totalit të shpenzimeve buxhetore i dedikohej politikave me bazë gjinore, ndërsa për vitin 2025 kjo përqindje është rritur në 9.1% (MF, 2025).¹⁹ Paralelisht, është rritur numri i programeve buxhetore që integrojnë komponentë gjinorë – nga 19 programe në vitin 2016 në 77 në vitin 2025, që përfaqëson më shumë se 58% e totalit të programeve ekzistuese në nivel qendror (KLSH, 2024).²⁰

Megjithatë, ajo çfarë konstatohet është fakti se kryesisht planifikimi i produkteve të targetuara si produkte të ndjeshme gjinore vazhdon të mbetet brenda kornizës së sektorëve socialë, ku përfshihen arsimi, shëndetësia, kultura, mbrojtja sociale, drejtësia apo edhe rendi publik. Programet në këta sektorë kanë përfituar nga fonde të dedikuara për mbështetjen e grave, vajzave, personave me aftësi të kufizuara, familjeve me të ardhura të ulëta dhe grupeve vulnerabël, duke synuar të zbusin pabarazitë gjinore dhe të promovojnë përfshirjen e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe ekonomike. Shembuj të tillë përfshijnë mbështetjen me ndihmë ekonomike (NE) për gratë e papuna

me shumë fëmijë si edhe mbulimin e pagesës së kontributeve shoqërore për këtë kategori deri në moshën 5-vjeçare të fëmijëve, NE për nënat e reja dhe pensionistet, ofrimin e bursave dhe librave falas për vajzat në shkolla, shërbimet shëndetësore të fokusuara te gratë, investimet në strehim për gratë viktimat të dhunës. Masat e ndërmarra për përmirësimin e aksesit në tregun e punës dhe për reduktimin e barrës së punës së papaguar të grave kanë qenë gjithashtu pjesë integrale e qasjes gjinore në politikat publike. Në të njëjtën kohë, praktika pozitive janë edhe produktet e Ministrisë së Drejtësisë për parashikimin e fondeve të dedikuara për ofrimin e mbështetjes me ndihmë juridike falas për gratë dhe vajzat viktimat të dhunës në familje apo viktimat të trafikimit.

Ndërkohë, nëse i referohemi aplikimit të të njëjtës praktikë në nivel vendor, vlen të theksojmë që në fillim se situata paraqitet ndjeshëm më e ndryshme. Raportet e realizimit të buxheteve në NJVQV tregojnë se praktikat e zbatimit të BPGJ në pushtetin vendor janë fragmentare dhe të paqëndrueshme. Identifikimi i objektivave dhe produkteve të ndjeshme gjinore ndodh në mënyrë sporadike dhe shpesh i mungon ndërlidhja me planifikimin afatmesëm dhe ciklin buxhetor vjetor.

Përpjekjet pozitive vijnë sidomos nga ato bashki që kanë nënshkruar Kartat evropiane për barazinë e burrave dhe grave në nivel vendor si edhe miratuar planet vendore të barazisë gjinore. Megjithatë, edhe në këto raste, ku janë identifikuar produkte të ndjeshme gjinore, pesha e tyre në buxhetin vendor është minimale. Pjesa më e madhe e fondeve që financojnë sektorët socialë në nivel vendor vjen nga transfertat e kushtëzuara të qeverisë qendrore, ndërsa hapësira e buxhetit të vetë bashkive është e kufizuar dhe nuk lejon alokime të ndjeshme gjinore në mënyrë të qëndrueshme. Për më tepër, mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë në nivel vendor dhe kapacitetet e kufizuara për të kryer analiza gjinore përbëjnë një pengesë të vazhdueshme në planifikimin dhe monitorimin e politikave publike me ndjeshmëri gjinore.

VI. Gjetje Kryesore dhe sfidat e aplikimit të BPGJ në politikat publike

Gjetjet e analizës së buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri tregojnë një ndërthurje problematikash të strukturuar që lidhen me zbatimin, monitorimin dhe institucionalizimin e kësaj praktike.

SFIDA 1:

ZBATIM FORMAL DHE JO EFEKTIV I KUADRIT LIGJOR PËR BPGJ

Së pari, një problem i identifikuar është mospërputhja ndërmjet kuadrit ligjor dhe zbatimit praktik të tij. Ndërsa legjislacioni shqiptar, si në nivel qendror (ligji nr. 9936/2008 dhe udhëzimi nr. 7/2018), ashtu edhe në atë vendor (ligji nr. 68/2017 dhe udhëzimi nr. 23/2018), parashikon detyrime të qarta për përfshirjen e objektivave gjinore në programet buxhetore dhe raportimin e treguesve përkatës, në praktikë këto detyrime shpesh injorohen ose përmbushen në mënyrë formale. Objektivat gjinore shpesh janë të paqarta dhe të paanalizuara në kontekstin real të nevojave gjinore. Një ilustrim i qartë vjen nga monitorimi i BPGJ në Bashkinë Elbasan (2023), ku megjithëse buxheti vendor

parashikon objektiva me bazë gjinore, ato shpesh mbeten të formuluar në mënyrë të përgjithshme, si “përmirësimi i aksesit në shërbime sociale”, pa indikatorë të matshëm dhe pa një analizë të plotë të ndikimit real mbi gratë dhe burrat (QDGJSH,2023)²¹. Raporti tregon se programet buxhetore nuk pasqyrojnë gjithmonë nevojat konkrete gjinore, duke e reduktuar BPGJ në një proces formal dhe jo një instrument transformues. Ky fenomen nuk është i izoluar. Raportet e tjera të monitorimit të BPGJ në nivel vendor të hartuara në kuadër të rrjetit për buxhetimin me pjesëmarrje gjinore (PRIZMA) nxjerrin në pah të njëjtën problematikë: në shumicën e bashkive, përfshirja e objektivave gjinore në dokumentet buxhetore bëhet për të plotësuar një kërkesë ligjore minimale, pa analiza të thelluara gjinore, pa tregues të qartë dhe pa një sistem monitorimi efektiv.²²

SFIDA 2:

MUNGESA E TË DHËNAVE TË NDARA SIPAS GJINISË DHE ANALIZËS SË BAZUAR NË TË DHËNA

Një tjetër gjetje shqetësuese është mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë, gjë që

pengon seriozisht aftësinë për të analizuar ndikimin e politikave buxhetore mbi gratë dhe burrat. Pothuajse në të gjitha raportet e performancës të institucioneve qendrore dhe vendore mungojnë indikatorët e matshëm për barazinë gjinore, duke e kthyer BPGJ në një ushtrim teorik dhe jo një praktikë të bazuar në prova. Kjo situatë është veçanërisht e dukshme në programet sociale, ku përfituesit nuk evidentohen sipas gjinisë, moshës apo statusit socio-ekonomik.

SFIDA 3:

KAPACITETE TË KUFIZUARA NJERËZORE DHE TEKNIKE PËR BPGJ

Nëpunësit gjinorë në institucione kanë mandate të kufizuara dhe, në shumicën e rasteve, nuk janë të përfshirë në mënyrë të qëndrueshme në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të programeve buxhetore. Ata zakonisht nuk janë pjesë e ekipeve teknike të planifikimit dhe hartimit të buxheteve institucionale, gjë që i përjashton nga vendimmarrja reale mbi prioritetet buxhetore.

Ndërkohë, përpjekjet për ngritjen e kapaciteteve janë fokusuar kryesisht në trajnimin e vetë nëpunësve gjinorë, duke anashkaluar nivelet e larta drejtuese — drejtues të njësive të financës, politikëbërës dhe anëtarë të ekipeve të menaxhimit institucional — të cilët kanë rol kyç në planifikimin dhe miratimin e buxheteve. Kjo mungesë e trajnimit të nivelit të lartë ka ndikuar në mungesën e vullnetit institucional për ta trajtuar BPGJ si një komponent

thelbësor të ciklit buxhetor dhe jo si një detyrim formal apo teknik.

SFIDA 4:

FRAGMENTARIZIM INSTITUCIONAL DHE MUNGESË BASHKËRENDIMI NDËRINSTITUCIONAL

Nga këndvështrimi i strukturës institucionale, mungon një mekanizëm i koordinuar ndërmjet ministrive, Ministrisë së Financave, dhe bashkive në lidhje me harmonizimin e politikave dhe praktikave gjinore në procesin e buxhetimit. Kjo sjell fragmentarizim dhe mospërputhje ndërmjet strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit vendor. Në disa raste, bashkitë përfshijnë objektiva gjinore për qëllime formaliteti dhe jo si pjesë e një analize reale për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e grave dhe grupeve të tjera të marginalizuara.

SFIDA 5:

PESHË E ULËT BUXHETORE DHE MUNGESË REALIZIMI TË PRODUKTEVE GJINORE

Përqindja e shpenzimeve gjinore mbetet ende relativisht e ulët në raport me nevojat strukturore për promovimin e barazisë gjinore. Edhe pse numri i programeve me komponentë gjinorë është rritur, kjo nuk është shoqëruar gjithnjë me një rritje proporcionale të fondeve të dedikuara për secilin program. Për më tepër, analizat e raporteve të realizimit tregojnë se jo të gjitha produktet me tregues gjinorë janë realizuar plotësisht ose nuk janë të shoqëruara me tregues të qartë matës për ndikimin e tyre.²³

SFIDA 6:

MUNGESA E MEKANIZMAVE TË VLERËSIMIT DHE AUDITIMIT GJINOR

Një tjetër sfidë e identifikuar është mungesa e vlerësimit sistematik të impaktit gjinor të politikave publike. Nuk ekziston një mekanizëm i standardizuar për kryerjen e analizave gjinore ex-ante dhe ex-post për programet dhe shpenzimet publike.

Monitorimi dhe raportimi për BPGJ mbetet një tjetër aspekt problematik . Në nivel qendror, megjithëse Udhëzimi Nr. 7/2018 përcakton kërkesën për përfshirjen e treguesve gjinorë dhe për raportimin mbi realizimin e tyre, shumica e institucioneve nuk e zbatojnë këtë në praktikë. Aneksi për Buxhetimin Gjinor që i bashkëngjitet PBA-së shpesh nuk është i integruar në proceset e monitorimit dhe nuk përmban të dhëna të plota mbi përfituesit sipas gjinisë. Në nivel vendor, edhe pse ligji nr. 68/2017 përcakton detyrimin për të raportuar tregues financiarë që lidhen me barazinë gjinore, këto kërkesa nuk zbatohen në mënyrë konsistente. Njësitë e vetëqeverisjes vendore rrallëherë përfshijnë tregues të matshëm gjinorë dhe nuk publikojnë të dhëna për shpenzimet që lidhen me objektiva gjinorë. Në këtë kuptim, mungon transparenca dhe llogaridhënia publike për zbatimin e BPGJ. Ndërtimi i një mekanizmi të mirëfilltë monitorimi dhe auditimi gjinor, si dhe përfshirja e shoqërisë civile në këtë proces, do të ndihmonin në rritjen e transparencës dhe efektivitetit të politikave publike.

SFIDA 7:

MUNGESA E PRAKTIKAVE TË QËNDRUESHME NË NIVEL VENDOR

Ndërkohë, në nivelin e vetëqeverisjes vendore mungojnë praktikat e qëndrueshme të BPGJ. Identifikimi i objektivave gjinorë është i rastësishëm, produktet gjinore kanë ndikim të kufizuar në buxhetet bashkiake, dhe shumë shpesh, nuk ndërlidhen me nevojat e përfituesve në terren. Në shumicën e bashkive, burimet e veta janë minimale dhe pjesa më e madhe e fondeve vijnë nga transferimet e kushtëzuara. Kjo kufizon fleksibilitetin e bashkive për të alokuar fonde që adresojnë nevoja të veçanta gjinore.

VII. Praktika Pozitive të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Shqipëri

Pavarësisht sfidave të shumta në zbatimin e BPGJ, analiza e buxhetit të planifikuar për vitin 2025 tregon një rritje të ndjeshme të ndërhyrjeve që synojnë grupe të caktuara gjinore dhe sociale. Këto ndërhyrje përfaqësojnë praktika pozitive që mund të shërbejnë si modele për përforcimin e qasjes së BPGJ në të gjithë ciklin buxhetor. Si shembuj pozitive përmenden: [24](#)

- **Mbështetje për pensionistet gra dhe të moshuarat e vetme**, duke synuar zbutjen e efekteve të inflacionit dhe vështirësive ekonomike pas humbjes së bashkëshortëve, si dhe njohjen e nevojave të veçanta sociale të tyre.
- **Skema të posaçme për gratë e papuna me shumë fëmijë dhe të ardhurat të ulëta**, duke nxitur përfshirjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë për familjet në situatë të vështirë.
- **Mbështetje për nënat që lindin gjatë vitit dhe janë aktive në tregun e punës**, duke forcuar lidhjen ndërmjet politikave të familjes dhe punësimit të grave.
- **Përkrahje për personat me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre**, me njohje të veçantë për punën e papaguar të grave në rolin e kujdesit familjar.

- **Zhvillimi i masave për strehimin social të grave të dhunuara, vajzave dhe familjeve një prindërore**, duke mundësuar aksesin në kushte të sigurt jetese për grupet vulnerabël.
- **Zgjerimi i shërbimeve shëndetësore parandaluese për gratë dhe vajzat**, veçanërisht në fushën e depistimit të kancerit të gjirit dhe qafës së mitrës, si dhe mbështetje për fertilitetin.
- **Rritja e përfaqësimit të grave në strukturat e sigurisë dhe rendit publik**, përmes rekrutimeve të reja dhe trajnimeve të dedikuara, duke kontribuar në barazinë gjinore në sektorët e kontrolluar tradicionalisht nga burrat.
- **Masa në mbështetje të arsimit për vajzat**, veçanërisht ato nga zonat rurale, përmes aksesit në transport, libra falas dhe mbështetje financiare për nxënëset në nevojë.
- **Zgjerimi i ofrimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe vajzat**, duke përmirësuar aksesin e tyre në drejtësi dhe mbrojtje ligjore.
- **Përfshirja e grave në skemat e mbështetjes për bujqësinë dhe zhvillimin rural**, përmes aksesit të drejtpërdrejtë në shërbime këshillimore dhe subvencione.

- **Promovimi i grave dhe vajzave në kulturë dhe trashëgimi, përmes mbështetjes së grave artizane dhe artisteve në skenën e pavarur kulturore.**

Këto praktika tregojnë se qasja e ndjeshme gjinore në planifikimin buxhetor mund të realizohet në mënyrë efektive kur ekziston vullneti politik dhe integrimi i objektivave gjinore në politikat sektoriale. Ndaj, ato duhet të përfshihen dhe përforcohen në strategjitë e ardhshme për institucionalizimin e BPGJ në Shqipëri.

VIII. Rekomandime Strategjike për forcimin e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinator

Bazuar në gjetjet e analizës së kuadrit ligjor, institucional dhe praktik të BPGJ, dhe duke u nisur nga sfidat e evidentuara në nivelin qendror dhe vendor, ky seksion propozon një seri rekomandimesh konkrete, të orientuara drejt advokimit për përmirësimin e politikave publike dhe rritjen e llogaridhënies për barazinë gjinore në menaxhimin e financave publike. Këto rekomandime janë të ndarasipas fushave prioritare të ndërhyrjes dhe mund të shërbejnë si bazë për ndërhyrje advokuese dhe nisma monitorimi nga shoqëria civile.

1.

RIVLERËSIMI DHE FORCIMI I BAZËS LIGJORE DHE STRATEGJIKE PËR BPGJ

- **Kërkohet përditësimi i udhëzimeve të Ministrisë së Financave për të sanksionuar në mënyrë të detyrueshme përfshirjen e objektivave dhe treguesve gjinorë në çdo program buxhetor të nivelit qendror dhe vendor.**
- **Rekomandohet përfshirja e qartë e buxhetimit të përgjigjshëm gjinator si komponent i detyrueshëm në strategjitë sektoriale dhe në dokumentet kombëtare të politikave publike.**

- **Shoqëria civile duhet të advokojë për ndërthurjen e kuadrit të BPGJ me ligjin e ri për barazinë gjinore, duke kërkuar dispozita të posaçme mbi buxhetimin dhe detyrimet e institucioneve publike.**
- **Rekomandohet përfshirja e objektivave mbi zbatimin e BPGJ në të gjitha Planet Vendore për Barazinë Gjinore që hartohen nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.**
- **Rekomandohet hartimi i një udhëzuesi metodologjik për BPGJ në përputhje me standardet ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e zbatimit të tij nga nëpunësit publikë në institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore.**

2.

RRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE DHE BURIMEVE NJERËZORE

- **Kërkohet fuqizimi i mandatit të nëpunësve gjinorë në të gjitha ministritë dhe bashkitë, me përshtime pune që përfshijnë konkretisht funksionet e BPGJ.**

- Duhet të institucionalizohen cikle trajnimi për zyrtarët financiarë, politikëbërësit dhe këshilltarët vendorë, në bashkëpunim me strukturat e trajnimit të administratës publike.
- OShC-të duhet të advokojnë për krijimin e një grupi të përhershëm ndërinstitutional, nën drejtimin e MF dhe MSHMS, për të koordinuar zbatimin dhe monitorimin e BPGJ në të gjitha nivelet e qeverisjes.

3.

ZHVILLIMI I SISTEMEVE TË INTEGRUARA PËR TË DHËNA GJINORE

- Rekomandohet ndërtimi i një baze të integruar të të dhënave të ndara sipas gjinisë për të gjitha programet dhe politikat publike, të aksesueshme nga aktorët e jashtëm (OSHC, media, akademja).
- Duhet të specifikohen indikatorët gjinorë të performancës për çdo program buxhetor, në mënyrë që monitorimi të mos mbetet formal.
- Kërkohet shtrirja e sistemit AFMIS me funksionin e “etiketimit gjinor/ gender tagging” edhe në nivel vendor, dhe përmirësimi i moduleve ekzistuese për të gjurmuar realisht shpenzimet me impakt gjinor.

4.

ZBATIMI I QËNDRUESHËM I BPGJ NË NIVEL VENDOR

- Rekomandohet që çdo bashki të hartojë dhe miratojë një Plan Vendor për Barazinë Gjinore, i lidhur ngushtë me ciklin buxhetor dhe i shoqëruar me kosto të qarta.
- Bashkitë duhet të përfshijnë minimalisht një produkt buxhetor me objektiv gjinor në çdo program për të përmbushur detyrimin ligjor sipas Ligjit për Financat Vendore.
- Shoqëria civile duhet të nxisë përfshirjen e qytetarëve, veçanërisht grave dhe grupeve të marginalizuara, në proceset e konsultimit publik për buxhetet e bashkive, duke përdorur buxhete qytetare të ndjeshme ndaj gjinisë.

5.

AFËRSIMI REAL I ALOKIMEVE BUXHETORE ME OBJEKTIVAT GJINORË

- Duhet të monitorohet përputhja me numrit të programeve me përfshirje gjinore dhe nivelit të financimit për barazinë gjinore, duke shmangur formalizmin.
- OShC-të duhet të advokojnë për prioritizimin e sektorëve me impakt të lartë gjinor, si arsimi, shëndetësia, drejtësia dhe punësimi, përmes analizës së strukturës së përfituesve.

- Të identifikohen dhe mbështeten buxhetet për programe të posaçme për gra të marginalizuara, përfshirë gratë në zona rurale, gratë me aftësi të kufizuara, dhe viktimat e dhunës me bazë gjinore.

6.

RRITJA E LLOGARIDHËNIES DHE TRANSPARENCËS NËPËRMJET AUDITIMIT GJINOR

- Të përfshihen komponentë të auditimit gjinor në skemat e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, me standarde të qarta për raportim.
- Të përgatiten raporte të posaçme të realizimit të buxhetit me fokus gjinor, si pjesë e dokumentacionit zyrtar të performancës buxhetore.
- Të krijohet një mekanizëm i pavarur i monitorimit dhe vlerësimit, me përfshirjen e Avokatit të Popullit, KLSH dhe organizatave të shoqërisë civile, që të publikojë periodikisht raportin kombëtar mbi zbatimin e BPGJ.

Fusnota

1. Udhëzim nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së “Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, shtojca nr.4
2. UN Women, BUXHETIMI I PËRGJIGJSHËM GJINOR NË SHQIPËRI Një manual për punonjëset dhe punonjësit e administratës publike qendrore dhe vendore, fq 15, shtator 2019
3. Birchall.J dhe Fontana.M (2015) “The gender dimensions of expenditure and revenue policy and systems”, fq 4.
4. Bryn Welham, Karen Barnes-Robinson, Dina Mansour-Ille and Richa Okhandiar(2018) “Gender-responsive public expenditure management :A public finance management introductory guide”, Overseas Development Institute, fq 7.
5. Ligj Nr 57/2016 “Mbi menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Neni 4/e I aksesueshëm tek https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/LOB_i_ri_nr.57_dt_02.06.2016_-_MIRATUAR_ne_KUVEND_version_integral.docx
6. Ligj Nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, i aksesueshëm tek <http://qbz.gov.al/eli/ligj/2017/04/27/68-2017>
7. Këshilli i Ministrave, Vendim nr. 400, datë 30.6.2021 “ Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planin e saj të veprimit” Qëllimi 4 i Politikës, i aksesueshëm tek <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>
8. Shih Ministria e Financave, Udhëzime për Buxhetimin e Përgjigjshëm gjinor, të aksesueshme tek <https://arkiva.financa.gov.al/legjislacioni-6/>
9. Birchall.J dhe Fontana.M (2015) “The gender dimensions of expenditure and revenue policy and systems”, fq 3.
10. INSTAT (2024), Anketa për Forcën e Punës.
11. Ibid.
12. INSTAT (2024) Burra dhe Gra, Të dëmtuar sipas gjinisë për veprën penale “Dhuna në Familje”.
13. Shih INSTAT (2024), Anketa për Forcën e Punës.
14. Ibid.
15. UNICEF. “Bridging the Gender Digital Divide.” UNICEF DATA, 26 Apr. 2023, data.unicef.org/resources/ictgenderdivide/.
16. Birchall.J dhe Fontana.M (2015) “The gender dimensions of expenditure and revenue policy and systems”, fq 3.

17. Shih për më tepër, metodologjinë e hartuar nga Komisioni Evropian në bashkëpunim me Institution Evropian për Barazinë Gjinore të referuar tek https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/eu-budget/performance-and-reporting/horizontal-priorities/gender-equality-mainstreaming_en
18. Shih Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 : **Objektivi specifik IV.2:** Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror. **Objektivi specifik IV.3:** Mbështetja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor
19. Ministria e Financave (2025) Relacion mbi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2025” , seksion 9.6 Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor, i aksesueshëm tek <https://financa.gov.al/projektbuxheti-2025/>
20. Shih gjithashtu, Kontroll i Lartë i Shtetit (2024), Raport Auditimi Performance “Fuqizimi Ekonomik i Gruas në vendin tonë”, fq.24-26.
21. Qendra për Drejtësi Gjinore (2023), *Raporti i Monitorimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në Bashkinë Elbasan i aksesueshëm tek <https://gjalbania.org/publikime/>*
22. Raporte të tilla janë hartuar në Bashkitë Dropull, Vau i Dejës, Tiranë, Shkodër, Vorë, Gjirokastrë, Divjakë, Maliq etj.
23. Shih për më tepër, Ministria e Financave, Raportet e monitorimit të realizimit të buxhetit në institucionet qendrore, viti 2024-2025.
24. Praktikat pozitive janë marrë nga buxheti vjetor 2025, seksioni 9.6 Relacioni i buxhetit 2025 i aksesueshëm tek <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/10/Relacioni-PB-2025.doc>

